



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 48/16

Prishtinë, më 23.03.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – zëvendës ministër i Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Rejhane Zylfijaj-GIZ, Besmir Rokollari-Drejtor Ekzekutiv në ICHAT, Agon Gashi-këshilltar ligjor-PILPIG, Fjolla Uka- monitoruese nga KDI, Amire Qamili – Gazetare nga BIRN, Die Morina-Gazetare nga Top Chanell, Dibran Istreti-Gazetar nga Klankosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajur e Komisionit, dt. 7.03.2016;
3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Gllgovcit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Mitrovicesë Veriore për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i Buxhetit të komunës së Leposaviqit për vitin 2016;
6. Shqyrtimi i Buxhetit të komunës së Zubin Potokut për vitin 2016
7. Shqyrtimi i buxhetit të Komunës së Zveqanit për vitin 2016;
8. Miratimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projektligjinë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 7.03.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Gllgovcit për vitin 2016

Kryetari – sqarojë se buxheti i të gjitha komunave që i kemi radhitur për shqyrtim, është si pasojë e asaj që këto komuna nuk e kanë aprovuar buxhetin me kohë dhe tani është vepruar siç e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë(LMFPP). Në baze të nenit 62.4. të LMFPP, nëse kuvendi komunal i ndonjë komune, miraton buxhetin e saj pas miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës nga ana e Kuvendit të Kosovës, për vitin e ardhshëm fiskal, atëherë i dorëzon Ministrit të Financave propozim-buxhetin komunal dhe kërkesën për ndarje buxhetore. Ministri duhet që menjëherë t’ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila i’a dorëzon këto dokumente Kuvendit. Kuvendi mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që ta ndryshojë Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Ndarjet Buxhetore, për t’i pasqyruar dokumentet e dorëzuara. Komuna e Gllgovcit, e ka ri-aprovuar buxhetin më datë. 10.02.2016, me vonesë dhe e ka dërguar në Ministrinë e Financave, e cila përmes qeverisë e ka dërguar në Kuvend. Në propozim buxhetin e riaprovuar të Komunës së Gllgovcit për vitin 2016, është paraqitur buxheti i kësaj komune sipas tabelave 4.1, 4.2. dhe 4.3. Në bazë të sqarimeve të dokumentacioneve të bashkangjitura nga Komuna e Gllgovcit është thënë se buxheti është në pajtueshmëri me kufijtë e përcaktuar në qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria në vitin 2015.

Agim Krasniqi – theskoi me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, komuna e Gllgovcit e ka riparovuar buxhetin me harmoni me qarkoren 1, 2 dhe 3 që e ka lëshu ministria e financave në vitin 2015. Kështu sipas vendimit të fundit buxheti i kësaj komune për vitin 2016 do të jetë 12,710.648 euro, edhe duke pas parasysh mbështetjen ligjore dhe qarkoret buxhetore, ministria e financave sugjeron me e aprovu buxhetin e kësaj komune.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Gllgovcit për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Gllgovcit, me datë 10.02.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

4. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Mitrovicës Veriore për vitin 2016

Kryetari – sqaroi se është e njëjtë situatë sikurse tek komuna paraprake, Komuna e Mitrovicës Veriore ka aprovuar buxhetin me vonesë me 24.02.2016 dhe është vepruar sipas procedurës siç e parasheh LMFPP.

Agim Krasniqi – sqaroi se Komuna e Mitrovicës Veriore e ka riaprovuar buxhetin me dt. 24.2.2016 në harmoni me qarkoret buxhetore 1,2 dhe 3 dhe buxheti i kësaj komune për vitin 2016, do të jetë 4,970,832 euro. Po ashtu u përkujtoj se nëse i marrim tabelat e buxheti edhe tabelat ndihmëse për këto komuna përputhen edhe ligji për menagjimin e financave publike e përgjegjësitë, kështu që ministria ju rekomandon për me e aprovu buxhetin e kësaj komune.

Fikrim Damka - i kam analizuar të gjitha buxhetin e këtyre komunave dhe një vërejtje që e kam pa është lidhur me punësimin e stafit, sidomos në arsim. Në arsimin parashkollor, në qerdhet në veri janë futur 41, në Leposaviq 30, në Zubin Potok 50 , në Zveçan 42, mësimdhënës. Të marrim shembull në

Zubin Potok i cili gjithsejt ka 6,537 banor, ka 50 edukator për arsim parashkollor dhe qerdhe, në Prizren janë diku 170,000 banor dhe gjithsej kemi 65 edukator. Në mesare po i bjen që një edukator në Prizren po mban mësim me 42 nxënës, ndërsa në Zubin Potok për dy nxënës një edukator. Pyeti zëvendësministrin, a keni verifikuar stafin në këto komuna apo i keni marr shifrat ashtu siç ju kanë ardhur nga komunat? Në Leposaviq, për arsimin fillorë paga mesatare është 189 euro e për arsimin parashkollor arrin afër 500 euro. Këtu ka disa mospërputhje me shifrat me arsimin në këto komuna. Nuk i kam analizuar shifrat në shëndësi e në tjera, por shifet se stafi i komunës janë diku 14, ku në disa ministri nuk ka kaq staf ministri.

Kryetari - duke marr parasysh se komisioni i granteve punon në formula unike në të gjitha komunat e Kosovës dhe nuk ka përjashtime për asnjë komunë. Për më tepër kërkojë sqarime nga zv. ministri për shqetësimet që u ngritën.

Agim Krasniqi – ministria, respektivisht qeveria ka për obligim me i nda grantet sipas formulave për secilen komunë, e komunat kanë autorizime dhe kanë të drejtë përmes kuvendeve komunale me bashkëpunimin e buxhetit brenda programeve e nënprogrameve. Ne i kemi analizuar buxhetin e këtyre komunave dhe e kemi pa që ka gjëra që nuk janë logjike, mirëpo është vendim i kuvendit komunal, pasi që i kanë autorizimet e bazën ligjore me vendos. Edhe ne mendojmë se ende nuk është përfunduar procesi i problemeve me qështje të edukimit dhe përfshirjes së gjithë stafit dhe ajo do të duhet të rregullohet por ajo duhet të bëhet nga komuna.

Besa Gazherri - unë nuk kisha pas qka me shtue kolegut që i tha të gjitha, por zv. ministër e kemi parasysh se kuvendet komunale aprovojnë buxhetin, por sistemi i listës së pagave nuk duhet as nuk mund të pranojë pagë 500 euro për punëtorët e qerdhës. Shifet se në këto komuna kemi mospërputhje të numrit të punësuarve që është e pa pranushme dhe ju duhet urgjentisht e me shikue dhe verifikue listën e pagave. Ju e dini se asnjë komunë nuk mundet me u punësue pa e ditë qeveria, e as me hy në arsim pa u trajtuar qështja nga ministria e arsimit.

Agim Krasniqi - ju njoftoj se nuk ka pagë 500 euro për një arsimtar në një komunë e në një komunë tjetër 300 euro. Pagat janë të nivelizuara. Në rast se kuvendi komunal merr vendim për punëtor, kjo duhet të bëhet brenda rregullimeve të brendshme dhe buxhetin të ndarë sipas ligjit. Pagat mirren sipas nivelit që ekziston për pozita të caktuara, e nuk një sistemi pagë tjetër. Aty mund të ketë rialokime brenda fondeve për stafin tjetër.

Fikrim Damka – unë sa po shoh tek Zubin Potoku, të arsimi e shkenca, shpenzimet për paga dhe mëdijtje në total janë 800,000 euro, dhe krejt janë grante qeveritare.

Agim Krasniqi - sqaroj se ndarja e granteve përcaktohet mbi bazën e normave apo formulës së përcaktuar me ligj. Nëse komuna don për një normë me i punësue dy punëtorë për një pagë që përcaktohet me normë të plotë është nën autoritetin e komunës.

Fikrim Damka – nëse për një normë me 20 orë ndahet në mes dy profesorëve, atëherë në do të kishim zgjidhur tërë problemin e punësimit.

Labino Ademi - gjetjet që i ceku kolegu janë jo logjike dhe mbeten si të tilla edhe për ne. Në anën tjetër u cek pavarësia e komunave, ndërkohë që shumica prej nesh kanë qenë këshilltar komunal apo edhe në nivel të tjera, në vazhdimësi kuvendet komunale ankohen për një pavarësi jo të duhur prej nivelit qëndror. Por, kur kemi qështje logjike e jo logjike është nevojë për bashkëpunim në mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që me i heq njëherë e mirë gjitha këto gjetje jo logjike të cilësuar dhe sipas nesh dhe sipas jush.

Agim Krasniqi - si ministri e financave kemi përgjegjësi që komunat ti trajtojmë njesojë dhe sipas ligjit sa i përket financimit. Por ju e dini, siç e di edhe unë, atje ekziston problemi i përfshirjes në sistem që është dasht edhe po duhet që çdo dite me punue, që me u përgaditë buxheti mbi bazën e standardit pak a shumë siq janë në komunat tjera. Tash po them ka qenë me rëndësi me u ruajt struktura e ligjit dhe autoritetet kanë pas një fleksibilitet më të madh në komunat veriore, por në në proces duhet me i përmirësu këto gjëra.

Adem Grabovci - kolegët që i ngriten këto shqetësime janë të bazuara, janë të drejta e shumë të arsyeshme, por e kemi parasysh edhe realitetin. Ne mund ti aprovojmë buxhetin, por me vërejtje që u thanë. Në të ardhmën edhe qeveria edhe ne duhet me kontribue më shumë që vërtetë integrimi është tepër i rëndësishëm dhe një ditë duhet t'iu vie fundi këtyre privilegjeve të shumta.

Besa Gaxherri – ne jemi të vetëdishëm që të gjithë po punojmë për integrimin e kësaj pjese të Kosovës, por çështja e buxhetit është qështje teknike, dhe e nuk guxojm me aprovu diqka që është kundërshtim me rregullatë buxhetore të republikës së kosovës. Nuk bën të na vijnë kështu kërkesat për aprovim dhe duhet me pas kujdes zv.ministër, duheni me pas ekipe për me i shikue dhe rregullu këto gjëra.

Agim Krasniqi - po flas në kuptimin e përgjithshëm nuk ka privilegje dhe të gjitha standartet tek ndarja e grandteve janë të barabarta sipas ligjit. Paqartësia është tek numrat brenda që janë pjesë e vendimeve komunale dhe kjo nuk është për herë të parë që po ndodh. Por ne kemi punuar me kuvendet komunale, ju kemi ofru asistencë dhe prap iu ofrojmë dhe kjo varet edhe prej nivelit e gadishmërisë së kuvendëve komunale.

Kryetari – thekoi se ne mund të përkrahim buxhetin e komunave të riaprovuar me vonesë, por që ministria e financave duhet ti shtojë aktivitetin dhe kapacitetet në monitorimin dhe analizimin e të gjitha vërejtjeve që u ngritën nga deputetët dhe të bëhen korigjimet e nevojshme dhe që të mos ketë keqmenaxhim me mjetet buxhetore, së në nivelin lokal po ashtu edhe atë qendror.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Mitrovicës Veriore për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore, me datë 24.02.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i Buxhetit të komunës së Leposaviqit për vitin 2016

Kryetari – e kemi të njëjtën situatë sikurse me dy komunat pararpake, Komuna e Leposaviqit e ka riaprovuar buxhetin me 29.20.2015 dhe është proceduar në pajtim me LMFPP.

Agim Krasniqi - po edhe kjo komunë ka riaprovuar buxhetin mbi bazën e qarkoreve buxhetore, dhe buxheti për komunën Leposaviqit pas riaprovimi është 3,444,718 euro, e ne ju rekomandojm me aprovue këtë buxhet.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Leposaviqit për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Leposaviqit, me datë 29.02.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

6. Shqyrtimi i Buxhetit të komunës së Zubin Potokut për vitin 2016

Kryetari – komuna e Zubin Potokut ka aprovuar buxhetin me vonesë me 29.02.2016 dhe i njëjti është proceduar në pajtim me LMFPP.

Agim Krasniqi - komuna e Zubin Potokut e ka riaprovu buxhetinë me 29.02.2016 mbi bazën e tre qarkoreve buxhetore dhe buxheti i kësaj komune është 1,853,910 euro dhe ne ju rekomandojmë me aprovue këtë buxhet.

Kryetari –keni parsysh se shqyrtimi i buxhetit në këtë fazë është i bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike, se përndryshe lidhur me Zubin Potokun, kishim fol ndryshe, kur dihet se janë edhe dy fshatra të banuara me shqiptar.

Besa Gaxherri – ne duhet ti kontrollojmë listat e pagave dhe të shofim se a do të shkojnë këto paga për arsimtarët parashkollor apo po i keqpërdorin duke u arsyetuar se po i ndajnë për norma tjera.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Zubin Potokut për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Zubin Potokut, me datë 29.02.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

7. Shqyrtimi i buxhetit të Komunës së Zveçanit për vitin 2016

Kryetari - komuna e Zveçanit ka riaprovuar buxhetin më 29.2.2016 dhe është proceduar në pajtim me LMFPP.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, nxorri këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Ministrisë së Financave, që Buxheti i Komunës së Zveçanit për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Zveçanit, me datë 29.02.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

8. Miratimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare

Kryetari – njoftoi se komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara, nuk kanë bërë ndonjë vërejtje. Kërkohej një votim formal i raportit me rekomandime për procedimin e shqyrtimit të dytë të projektligjit në seancë plenare.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

P ë r f u n d i m

- I. Miratohet Raporti me rekomandime lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara, procedohet për shqyrtim të dytë në Kuvend.

9. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit, se Ministri i Punës dhe Mirqënies Sociale, ka dërguar një shkresë ku njofton se në lidhje me Projektin kapital “Ndërtimi i objektit për banim social, për familjet e lagjes Trepça të Stan Tërgut – Mitrovicë”, aktualisht me buxhet të Kosovës për këtë vit, janë të ndara 90,000 euro. Ndërkaq, në bazë të ofertave të pranuar, në procedurat e tenderimit, oferta më e lirë e përgjegjshme është 287,594.48 euro. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projekti që është i karakterit social për familjet që janë në kushte të vështira të banimit, në emër të Komisionit, iu kam përgjigjur Ministrit, se Komisioni do të sigurojë ndarjen e mjeteve prej 197,594.48 euro për përfundimin e projektit në fjalë, me rishikimin e buxhetit 2016.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani